VENDIM
Nr.316, datë 5.5.2010

PËR AKORDIM FONDI KOMUNËS MILOT TË QARKUT TË LEZHËS, PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE FAMILJES SË Z. GJETAN PJETËR LALA, SË CILËS I ËSHTË DËMTUAR BANESA NGA FATKEQËSITË NATYRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13 të ligjit nr. 10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010" dhe të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Milot të qarkut të Lezhës, në buxhetin e vitit 2010, t'i akordohet fondi prej 1 061 800 (një milion e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind) lekësh, për t'iu dhënë si ndihmë financiare familjes së z.Gjetan Pjetër Lala, së cilës i është dëmtuar banesa nga fatkeqësitë natyrore.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut të Lezhës dhe komuna Milot për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha